



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2651, datë 03.12.2015

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a kundër Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr. 2617 dhe Nr. 2619, datë 08.10.2015”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 03.12.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a kundër Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr. 2617 dhe Nr. 2619, datë 08.10.2015”

BAZA LIGJORE:

- 1) Nenet 31 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (ligji nr. 9918);
- 2) Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar (ligji nr. 8485);
- 3) Rregullore për analizën e tregut, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;
- 4) Udhëzues për Procedurat e Keshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit (*Relacioni*),
2. Ankimi administrativ i sipërmarrësit Altelecom sh.a për ndryshim të pjesshëm të Vendimeve të Këshillit Drejtues Nr. 2617 dhe 2619 të datës 08.10.2015, dërguar me shkresën Nr.2002 Prot., datë 09.11.2015.
3. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP me Vendimin Nr. 2617, datë 08.10.2015, miratoi dokumentin “*Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokument Përfundimtar*” dhe me Vendimin nr. 2619, datë 08.10.2015 miratoi “*Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjet fiks*”. Miratimi i dokumenteve u krye pas procesit të këshillimit publik, gjatë së cilës AKEP mori në konsideratë komentet e dërguara nga palët e interesuara.
2. Altelecom sh.a me shkresën me Nr.8685, datë 09.11.2015 (referenca e AKEP: Nr.2002 Prot., datë 09.11.2015) ka dërguar ankim administrativ duke kërkuar ndryshimin e disa pikave të Vendimeve nr.2617 dhe 2619, datë 08.10.2015. Ankimi i Altelecom është kryer brenda afateve të përcaktuara nga Kodi i Procedurave Administrative. Kërkesat dhe argumentat kryesore të Altelecom për ndryshimin e vendimeve të cituara janë si më poshtë:
 - 2.1. Altelecom kërkon që AKEP, duke ruajtur gjithashtu parimin e simetrisë së tarifave të terminimit me operatorët e tjerë fiks, të përcaktojë:
 - a. aplikimin e tarifës (FTR) 1.52 lek/min deri në Analizën e Tregut të radhës, ose në mënyrë alternative në rast mos pranimit të kësaj kërkesës,
 - b. një përshkallëzimi më të zbutur të reduktimit të tarifës së terminimit në fazën e parë dhe të dytë, si më poshtë:

Periudha	1.01.2016	01.01.2017 (deri në vendimin e analizës së rradhës)
Tarifa e terminimit ne Altelecom	1.52 lekë/min	1.32 lekë/min

- Altelecom konfirmon edhe një herë qëndrimin e tij për mbajtjen të pandryshuar të tarifës 1.52 lek/min deri në Analizën e Tregut të radhës, duke krijuar kështu mundësinë për një maturim sa më të mirë të fazës përmbyllëse të kalimit me një segment të vetëm kombëtar. Sipas Altelecom kjo kërkesë është më se e logjikshme nëse marrim në konsideratë edhe

angazhimin e tyre për të mundësuar lidhjen në 12 pikat e interkoneksionit të paktën edhe për 2-vjecarin e ardhshëm, heqjen e tarifës për thirrje nga 01.01.2016, kohën akoma të shkurtër të maturimit të rrjetit NGN të Albtelecom, si dhe faktin që akoma nuk janë në fazën e interkoneksionit me IP për shkak të topologjisë së rrjetit të operatorëve alternativë etj.

- Albtelecom vlereson se tarifa mesatare e ponderuar e trafikut të terminuar në rrjetin fikse të tij, nga të gjithë operatorët e tregut të komunikimeve elektronike qoftë për vitin 2014 e qoftë për vitin 2015 (deri në Gusht) rezulton 1.69 -1.72 lek min. Reduktimi i saj në dokumenti për këshillim në 1.52 lekë/min megjithëse i konsiderueshem u pranua nga Albtelecom duke i sjelle një ulje të të ardhurave nga terminimi në rrjetin e tij afërsisht 11.6% në krahasim me tarifën e ponderuar të llogaritur prej Albtelecom dhe akoma më shumë kjo humbje financiare thellohet me ~14% me aplikimin e tarifës 1.48 lek/min.
- Albtelecom mendon se, për vetë karakteristikat dhe zhvillimet e tregut të telefonisë fikse nga njëra anë dhe problematikave të ndeshura dhe të evidentuara në vite në tregun e telefonisë së lëvizshme nga ana tjetër, barazimi i MTR-ve dhe FTR-ve nuk mund dhe nuk duhet të bëhet qëllim në vetvete. Zhvillimet, ecuria, dhe karakteristikat në secilin nga këto tregje janë tejet të ndryshme, dallimet mes të cilave janë të renditura si më poshtë:
 - norma e penetrimit në telefoninë fikse ka ardhur në ulje nga 11% në 9% për vitin 2014, në të kundërt ajo e telefonisë së lëvizshme për vitin 2014 është 119% për përdorues aktivë, dhe mbulohet mbi 99% e popullsisë,
 - përqindja e thirrjeve të origjinuar nga rrjete fikse është 3% kundë aty të origjinuara nga rrjete celulare në 97%,
 - ndryshimi i fokusit të abonentëve të Albtelecom nga telefonia fikse drejt shërbimeve të internetit/të integruara me bazë përdorimin e aksesit në broadband dhe jo shërbimin e telefonisë fikse në vetvete.
 - nëse i referohemi treguesve të MOU për telefoninë fikse dhe atë të lëvizshme vihen re trende totalisht në kah të kundërt
 - ulja e shpenzimit mesatar për minutë në telefoninë celulare (ARPM), në 2.63 lek/min në vitin 2014 (rrjedhje e praktikave problematike të diferencimit të thirrjeve on-net/off-net), krahasimisht me treguesin ARPM për abonentin e telefonisë fikse që rezulton 3.2 lek/min për vitin 2014.

Albtelecom konkludon se treguesit demonstrjnë qartë se fenomeni i zëvendësueshmërisë së thirrjeve është mjaft i theksuar në rastin e tregut të telefonisë në Shqipëri ku thirrjet nga rrjetet fikse janë zëvendësuar në masë të konsiderueshme me thirrjet nga rrjetet celulare.

- Tregu i telefonisë fikse në Shqipëri nuk paraqet në asnjë komponent të tij problematika/ngjashmëri me tregun e telefonisë mobile, ku për adresimin e duhur të këtij

problemi ishte më se e domosdoshme reduktimi i konsiderueshëm MTR nga Dhjetori 2014. Ndërkohë që, pjesët e tregut të operatorit kryesor në tregun e telefonisë fikse Albtelecom, vit pas viti kanë ardhur duke u ulur, si përsa i takon numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse ashtu dhe në pjesët e tregut të numrit të pajtimtarëve me akses broadband.

- Pikërisht, këto karakteristika të ndryshme për tregun e telefonisë fikse dhe tregun e telefonisë së lëvizshme, shpjegojnë qartë mosarritjen e ekonomive të shkallës nga operatorët në tregun e telefonisë fikse që rrjedhimisht çon në kosto më të larta për njësi për rrjetet fikse në Shqipëri, dhe për më tepër në pamundësi për kthimin e investimeve të ndërmarra për modernizimin e rrjetit fiks nga operatorët, konkretisht Albtelecom.
- Bazuar në llogaritjet e tij Albtelecom sqaron se, edhe nëse i referohemi trafikut për të njëjtën periudhë kohore por për vitin 2015 (koha para fillimit të konsultimit publik), kjo tarifë mesatare e ponderuar rezulton të jetë 1.29 lek/min, pra edhe në këtë rast është shumë larg vlerës së tarifës prej 1.09 lek/min përcaktuar në Vendimin nr. 2619 për periudhën e dytë të përshkallëzimit. Albtelecom shpjegon se pëson humbje nga reduktimi i tarifës së terminimit edhe me aplikimin e tarifës së propozuar nga Albtelecom 1.32 lek/min (~23%) dhe akoma më shumë kjo humbje financiare thellohet me 37% me aplikimin e tarifës 1.09 lek/min të përcaktuar në vendimin 2617.
- Kërkesa e Albtelecom për të mos reduktuar tarifën e terminimit për fazën e dytë të përshkallëzimit me një normë përqindjeje jo më shumë se 15% dhe përcaktimi i një tarife të ndërmjetme terminimi 1.32 lek/min duke filluar nga 01.01.2017, përveç se për shkak të impaktit negativ direkt në të ardhurat e Albtelecom nga reduktimi i tarifës (së terminimit), mbështetet edhe nga argumentat e mëposhtme:
 - heqja përfundimtare e tarifës për thirrje në shërbimet e terminimit dhe tranzitimit duke shkaktuar mungesën përfundimtare të të ardhurave prej 0.38 lek/thirrje të një volumi thirrjesh nga 2-3 milionë thirrje në muaj.
 - angazhimin e shprehur të Albtelecom përcaktuar dhe në vendimin nr. 2619 për mbajtje të 12 pikave të interkoneksionit edhe për 1 vit më shumë nga afati i propozuar nga AKEP (deri në fund të vitit 2017), shoqëruar kjo edhe me fasilitim apo uljen drastike të cmimeve të shërbimeve të lidhjes me linjë me qera me rreth 70% drejt këtyre pikave
 - sigurimin e një procesi gradual dhe të shtrirë në kohë për operatorët alternativë për kalimin/lidhjen e tyre të detyrueshme në një nga 2 pikat e interkoneksionit të Albtelecom;
 - si dhe, dëmtimet që i shkaktohen Albtelecom-it nga të tretët në infrastrukturë në mënyrë të theksuar krahasimisht me dëmtimet e kësaj natyre që ndodhin në vëndet e zhvilluara të BE dhe që çojnë në kosto shtesë të tij për mbajtjen e backup-eve të rrjetit për sigurimin e parametrave të duhur dhe në përputhje më SLA e shërbimit.

2.2. Në lidhje me tarifën e tranzitimit, Albtelecom kërkon që AKEP të përcaktojë:

- a. aplikimin e tarifës e tranzitimit me 1.1 lekë/min deri në Analizën e Tregut të radhës ose në mënyrë alternative në rast mos pranimit të kësaj kërkesë,
- b. një përshkallëzim më të zbutur si më poshtë:

Periudha	1.01.2016	01.01.2017 (deri në vendimin e analizës së rradhës)
Tarifa e tranzitimit te Albtelecom	1.1 lekë/min	0.8 lekë/min

- Ashtu sikurse dhe në rastin e tarifës së terminimit ku nga 1.85 lekë/min që është tarifa aktuale e segmentit dyfish ku terminohet pjesa më e madhe e trafikut në rrjetin e Albtelecom, reduktimi në 1.52 lek/min përbën ~20%, po në të njëjtën mënyrë Albtelecom vlerëson se edhe reduktimi i tarifës së tranzitimit aktual (1.32 lek/min) nuk duhet të jetë më shumë se 20%, pra të rezultojë në afërsisht 1.1 lek/min (proponuar edhe në komentet e Albtelecom). Kjo analizë bazohet mbi të dhëna të sjella nga ALbtelecom lidhur me trafikun e tranzituar dhe impaktin në të ardhura si rrjedhojë e ndryshimit të tarifës së tranzitimit. Reduktimi i tarifës së tranzitimit sipas glidepath-it të përcaktuar në vendimin 2619 i shkakton Albtelecom ulje të konsiderueshme të të ardhurave nga tranzitimi i trafikut kombëtar që varion nga 30% për periudhën e parë në 48 % në periudhën e dytë nga 01.01.2017. Albtelecom serish iu referohet të njëjta fakteve te perdorura per analizen e FTR dhe disa të cilat renditen më poshtë:
 - burimet e nevojshme apo infrastruktura që kërkon procesi për llogaritjen e trafikut dhe kostot administrative që shoqërojnë këtë proces për mbyllje të faturimeve ndërmjet palëve, mbartjen e detyrimeve të operatorëve që tranzitojnë trafikun, etj;
 - dëmtimet që i shkaktohen Albtelecom-it nga të tretët në infrastrukturë në mënyrë të theksuar krahasimisht me dëmtimet e kësaj natyre që ndodhin në vëndet e zhvilluara të BE dhe që cojnë në kosto shtesë të tij për mbajtjen e backup-eve të rrjetit për sigurimin e parametrave të duhur dhe në përputhje më SLA e shërbimit;
 - investimet e konsiderueshme të bëra nga operatori kryesor Albtelecom, detyrimisht kthim të vonë nga investimi si rezultat i përdorimit në rënie të shërbimeve të telefonisë fikse dhe uljes së penetrimit të saj dhe për rrjedhojë mosarritjes së ekonomive të shkallës

2.3. Albtelecom i kërkon AKEP heqjen e detyrimit për ndarjen e llogarive dhe llogaritjet e kostove në tregjet e terminimit të thirrjeve dhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare. Në mënyrë të përmbledhur Albtelecom paraqet si më poshtë të gjitha argumentet dhe rrethanat mbështetëse:

- 1) Në vendimin përfundimtar të Analizës së Tregut të Telefonisë Fikse është vendosur kalimi në një segment të vetëm, në një tarifë të vetme kombëtare, me glidepath drejt

dysshemesë, apo në një të ardhme relativisht afatmesme mesataren benchmark të vendeve të BEREC;

- 2) Ulja e tarifave të terminimit drejt dysshemesë ka qenë argumenti kryesor i përdorur nga AKEP në rastin e heqjes së detyrimit për ndarjen e llogarive nga tregu i terminimit në telefoninë e lëvizshme, ku reduktimi i bërë në tarifat e terminimit në rrjetet/operatorët e telefonisë së lëvizshme ka shërbyer si argument për ta gjykuar këtë detyrim si jo-propocional për shkak të ngarkesës së madhe për operatorin dhe procesit të gjatë që ajo krijon;
- 3) Në “Expalanatory notes” (C(2009) 3359 final,) të Rekomandimit të KE, pika 3.1.1 sqarohet se detyrimi i mbajtjes së llogarive nuk mund të vendoset paralelisht me detyrimin për caktimin e tarifave sipas benchmark-ut të vendeve që kane aplikuar metodologji kostoje. Kështu, në rastin e Altelecom rezultatet nga implementimi i këtij detyrimi do të rezultojnë në njëkohshme me fazën ku sipas AKEP, tarifa e terminimit të Altelecom janë parashikuar të shkojnë drejt benchmarkut të vendeve të BEREC të cilat deri në atë kohë, pjesa më e madhe e tyre do të ketë aplikuar metodologji kostoje për llogaritjen e tarifës së tyre të terminimit. Kjo do të përbënte barrë të rëndë për operatorin dhe masë jo propocionale në kuptim të nenit 34 të Ligjit për Komunikimet Elektronike dhe gjithashtu aplikimi i njëkohshëm i të dyja këtyre detyrimeve vjen në kundërshtim me Rekomandimin 2009/396/EC të Kuadrit Rregullator European të vitit 2009 dhe Direktivën 2005/698/EC;
- 4) Nuk do të shtonte asnjë vlerë qëllimit final të vendosjes së këtij detyrimi në vetvete për sa kohë që vendosja e këtij detyrimi tejkalon qëllimin për të cilin është vënë detyrimi dhe Altelecom do të jetë subjekt i tarifave tejet të ulta
- 5) Direktiva 2009/140/EC, në nenin 13 të saj përcakton se vendosja e detyrimit për mbajtjen e llogarive është e justifikueshme në rastet kur nga analiza e tregut evidentohet se mungesa e konkurrencës vjen për shkak të aplikimit të tarifave e interkoneksionit tepër të larta ose kur vërehen praktika anti-konkurrese në tregun e pakicës (psh: price squeeze). Nga ana tjetër, asnjë nga Autoritetet, si ai i Konkurrencës apo edhe AKEP nuk kanë trajtuar apo kanë patur objekt të shqyrtimit nga ana e tyre raste të praktikave anti-konkurrese në tregun e pakicës së telefonisë fikse, madje përkundrazi në dokumentin e analizës së tregut ky treg është analizuar nga AKEP dhe ka rezultuar të jetë në konkurrencë eficiente, dhe si pasojë Altelecom nuk është gjetur me fuqi të ndjeshme në këtë treg duke u zhveshur edhe nga masat rregullatore që gëzonte prej vitesh si operator me FNT në tregun me pakicë të telefonisë fikse.
- 6) Tregu i telefonisë fikse nuk paraqet në asnjë komponent të tij problematikat e ndeshura në vite në tregun e telefonisë celulare, për tu justifikuar operdorimin e ndarjes së llogarive, shpjegon me tej Altelecom duke sjelle edhe referenca rekomandimesh të BE. Bazuar në parimin e trajtimit të barabartë të ofruesve të shërbimeve të komunikimeve

elektronike sipas përcaktimit të nenin 7, pika ë) e Ligjit për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë, Albtelecom kërkon heqjen e detyrimit për mbajtjen e llogarive ashtu sic u hoq edhe për ofruesit e shërbimit të telefonisë së lëvizshme. Gjithashtu dhe për sa më lart, në tregun e telefonisë fikse nuk ndeshemi me asnjë nga rrethanat të cilat referohen nga Direktiva si rrethana që do të justifikonin detyrimin e ndarjes de mbajtjes së llogarive ndaj dhe mbajtja e këtij detyrimi përbën barrë të tepërt për operatorin dhe është e pajustificuar

- 7) Si pasojë e bashkimit të kompanive Albtelecom sh.a me Eagle Mobile sh.a, Albtelecom zbaton në mënyrë rigoroze detyrimin e ndarjes së llogarive për telefoninë fikse dhe atë të lëvizshme duke paraqitur informacion mbi mënyrën e mbajtjes së pasqyrave financiare të kompanisë dhe faturimet/transaksionet e brëndshme ndërmjet Albtelecom dhe Eagle Mobile.
- 8) Albtelecom mban të evidentuara dhe i është përgjigjur në cdo rast kërkesave për informacion nga Autoritetet në lidhje me të ardhurat dhe të dhëna të tjera për shërbimet nën rregullim. Nga mënyra se si janë mbajtur aktualisht llogaritë, është arritur të sigurohet transparenca mbi të ardhurat dhe të dhëna të tjera për produktet e rregulluara, të kërkuara nga AKEP
- 9) Ky detyrim praktikisht mbetet vetëm mbi Albtelecom nga të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe nga të gjithë sipërmarrësit me FNT, nga ku kostot financiare të konsiderueshme për implementimin, realizimin dhe finalizimin e tij pa përmendur koston e burimeve të brendshme, do të vendosin kompaninë në disavantazh të konsiderueshëm në këtë aspekt, sa kohë që kjo shumë financiare do të mund të përdorej për investime të tjera në lidhje me shërbimet e ofruara nga Albtelecom.
- 10) Kostoja për implementimin e këtij detyrimi, është tejet e madhe, për më tepër kur kosto tjetër shtesë po kaq e madhe do të duhej për procesin e auditimit të këtyre llogarive rregullatore. Por ndërkohë, detyrimet rregullatore për tarifat e terminimit, tarifat e LLU, tarifat e bitstream dhe tarifat e linjave me qera, në funksion të rregullimeve nga AKEP, kanë shkuar ose janë duke shkuar drejt cmimeve dysheme, cka do të vinin në dyshim jetëgjatësinë e rezultateve të detyrimit për ndarjen e llogarive. Për më tepër kur Albtelecom pikërisht gjatë vitit 2015 ka kryer rishikimin e mëtejshëm të tarifave për disa tregje nën rregullim që rezultojnë në tarifa drejt cmimeve minimale.

Albtelecom jep disa shembuj te reduktimeve te konsiderueshem te tarifave me shumice duke theksura se keto fakte demonstrojne se të gjitha tarifat e nivelit të shumicës dhe/ose për shërbime që ofrohen si inpute për operatorët për realizimin e një shërbimi nëpërmejt Albtelecom, kanë pësuar një ulje të konsiderueshme drejt niveleve minimale, nivele këto që ka shumë pak gjasa të jenë edhe më të ulta nga rezultatet e implementimit të detyrimit për ndarjen e llogarive

Sipas Albtelecom, qëllimi për të cilin kërkohet të zbatohet ndarja e llogarive, ku theksi vihet mbi cmimet e produkteve me shumicë, mund të konsiderohet plotësisht i ezauruar, dhe nuk do të ishte rracionale që të investohej një kosto aq e lartë në implementimin e një detyrimi të tillë kur vetë Albtelecom po tregohet proaktiv në reduktimin e tarifave të shërbimeve me shumicë.

Në këto rrethana, sa më sipër, ndërsa jetëgjatësia dhe efienca e rezultateve sipas kësaj metodologjie mund të rezultojë afatshkurtër, kostoja për të realizuar këtë projekt nuk do të mund të justifikohet dhe do të përbente një barrë të rëndë financiare për Albtelecom.

Për sa më sipër, dhe kur në secilin nga tregjet në rregullim, tarifat e aplikuar po shkojnë drejt reduktimit të konsiderueshëm, zbatimi dhe implementimi i detyrimit për ndarjen e llogarive, bën Albtelecom subjekt të trajtimit jo të barabartë ndërmjet ofruesve të shërbimeve dhe do të përbente një detyrim jo-proporcional dhe barrë të rëndë për Albtelecom, në kuptim të nenit 7, pika ë) dhe nenit 34, pika 5 të Ligjit nr. 9918 për Komunikimet Elektronike, i ndryshuar.

2.4. Në përfundim të argumentave të dhëna në ankimim, Albtelecom kërkon nga AKEP, pranimin e Ankimit dhe:

- **Ndryshimin e pjesshëm të** Vendimit të Këshillit Drejtues Nr.2617, datë 08.10.2015 për *“Miratimin të Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokument Përfundimtar”*, në lidhje me rishikimin në seksionin V.1 *“Masat rregullatore për tregjet me shumicë të interkoneksionit”* të vendosjes së detyrimit për ndarjen e llogarive dhe rishikimin e seksionit V.2 *“Rregullimi i tarifave me shumicë të interkoneksionit”*, për tarifat e interkoneksionit të Albtelecom; dhe,
- **Ndryshimin e pjesshëm të** VKD Nr.2619 datë 08.10.2015 për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjet fikse”* për ndryshimin e pikës 2/5 të Vendimit, në lidhje me detyrimin për ndarjen e llogarive dhe ndryshimin e pikës 3.5, *iii) Tarifat e shërbimeve me shumicë të interkoneksionit* dhe revokimin e pikës 3.5/*iv) mbi zbatimin e detyrimit të ndarjes së llogarive dhe mbajtjes së llogarive, si më poshtë:*

I. Ndryshimin e tarifave të interkoneksionit:

i. Tarifa e terminimit:

1.52 lek/min, që nga 01.01.2016 deri në Analizën e tregut të rradhës së telefonisë fikse;
Ose në mënyrë alternative

Reduktim më të butë të *“glidepath-it”* përshkallëzimit me:

1.52 lek/min që nga 01.01.2016 (nga 1.48 lek/min në VKD e AKEP)

1.32 lek/min që nga 01.01.2017 (nga 1.09 lek/min në VKD e AKEP)

ii. Tarifat e tranzitimit:

1.1 lek/min, që nga 01.01.2016 deri në Analizën e tregut të rradhës së telefonisë fikse;

Ose në mënyrë alternative

1.1 lek/min që nga 01.01.2016 (nga 0.93 lek/min në VKD e AKEP)

0.8 lek/min që nga 01.01.2017 (nga 0.68 lek/min në VKD e AKEP)

II. Revokimin e detyrimit për ndarjen e llogarive dhe mbajtjen e llogarive

3. AKEP pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe argumentet e Albtelecom sh.a vlerëson si më poshtë:

1) Në lidhje me pretendimet e ngritura nga Albtelecom për tarifat e terminimit/tranzitimit një pjesë e tyre janë marrë në konsideratë pas periudhës së këshillimit publik (të shprehura edhe në dokumentin e Analizës dhe aneksin nr.2, në qendrimet e AKEP ndaj komenteve të dërguara gjatë këshillimit publik). Pas procesit të këshillimit publik AKEP gjykoji që të bente disa ndryshime në vlerat dhe afatet e propozuara për tarifat e terminimit/tranzitimit dhe numrin e pikave të interkoneksionit, duke marrë parasysh kështu disa nga kërkesat e Albtelecom që janë të ngjashme me pretendimet në këtë ankim administrativ. Megjithatë AKEP, bazuar edhe në kërkesat e Albtelecom në këtë ankim administrativ, gjykon se:

- për fazën e parë të reduktimit të tarifave të terminimit në rrjetin Albtelecom dhe në rrjetet e operatorëve të tjerë fikse (përfshirë Telekom Albania për thirrjet drejt Telekom fiks), niveli 1.48 lek/minutë është i arsyeshëm dhe i justifikuar për t'u aplikuar duke filluar nga 1.01.2016, dhe se ai nuk përbën ndryshim të ndjeshëm nga niveli 1.52 lek/minutë i propozuar në këshillim publik (2 pikë përqindje). Ky nivel i tarifës unike të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare është në linjë dhe me konkluzionet e analizës së tregut për konvergjencën e shërbimeve telefonike fikse dhe celulare në Shqipëri.
- për fazën e dytë që fillon nga 1.01.2017 reduktimi i tarifës së terminimit në rrjetet fikse në nivelin 1.09 lek/minutë, megjithëse është një reduktim proporcional krahasur me nivelin e fazës së parë 1.48 lek/minutë dhe nivelin e synuar (target) të 0.7 lek/lek.minutë të fazës së tretë më 1.01.2018, mund të përbëjë një reduktim të ndjeshëm nga niveli aktual i tarifës së ponderuar të terminimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom (37%) dhe rrjetet e operatorëve të tjerë fikse, duke e bërë këtë reduktim të ndjeshëm jo-proporcional me kushtet aktuale të tregut Shqiptar dhe stimujt e operatorëve të rrjeteve fikse (Albtelecom dhe OA) për investime të mëtejshme në këto rrjete dhe sidomos në rrjetet NGN/NGA. Për AKEP, objektivi i rritjes së investimeve në këto rrjete dhe shërbime të reja të rrjeteve fikse është shumë më madhor se objektivi i rritjes së konkurrencës midis rrjeteve fikse/celulare për thirrje nga venddodhje fikse, pasi sic është konkluduar në analizën e tregut, operatorët e rrjeteve fikse për thirrjet telefonike kanë presion konkurrues më të madh nga rrjetet celulare se nga rrjetet e tjera fikse, dhe se këto të fundit kanë rënë më të madhe në rritjen e përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband në Internet se në shërbimet tradicionale të telefonisë fikse, të cilat po zëvendësohen gjithmonë e më shumë nga telefonia celulare dhe aplikacionet në Internet (OTT). Vlen të theksohet se me vendimet e AKEP të datës

8.10.2015, duke filluar nga nga 1.01.2016 tarifa e terminimit për thirrje shkon në 0 lek/thirrje nga 0.38 lek/thirrje aktualisht, duke cuar në reduktime të mëtejshme të të ardhurave nga terminimi i thirrjeve të operatorëve fikse (Albtelecom dhe OA). Duke marrë në konsideratë argumentat dhe të dhënat shtesë të Albletecom, si dhe sa më sipër, gjykojmë se për fazën e dytë, si nivel maksimal i tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom dhe në rrjetet e tjera, të përcaktohet tarifa 1.29 lek/minutë (në vend të 1.09 lek/minutë të përcaktuar me vendimet e datë 8.10.2015), që përkon me tarifën mesatare të ponderuar të terminimit që operatorët e rrjeteve fikse kanë paguar për terminimin e thirrjeve të pajtimtarëve të tyre në rrjetin Albtelecom në periudhën Janar-Gusht 2015. Kjo masë përbën një reduktim më të zbutur të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse.

- Në lidhje me tarifat e tranzitimit në rrjetin Albtelecom, AKEP bazuar në argumentimin e mësipërm gjykon që të mos ndryshojë nivelin e tarifës së tranzitimit në fazën e parë dhe të fundit të përcaktuar në Vendimet e datës 8.10.2015, por të ndryshojë vetëm tarifën në fazën e dytë (1.01.2017) nga 0.68 lek/minutë në 0.81 lek minutë. Ky ndryshim, së bashku me ndryshimin në tarifën e terminimit, con në reduktim të njëjtë në përqindje midis fazave 2 dhe 3 të tarifës së tranzitimit dhe të terminimit, krahasuar me fazat përkatëse parardhëse (13% reduktim në Fazën 2 dhe 46% në Fazën 3).
 - AKEP gjykon të rëndësishme monitorimin e ecurisë së zhvillimit të rrjeteve fikse gjatë kësaj periudhe deri në analizën e tregut të rradhës në vitin 2017, për të gjykuar përsëri në lidhje me fazën 3 të reduktimit të tarifave të terminimit/tranzitimit dhe efektet në rrjetet fikse në Shqipëri.
- 2) Në lidhje me detyrimin për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve kombëtare, AKEP thekson se kjo është një masë rregullatore që ndihmon në përcaktimin e kostove të ofrimit të shërbimit nga operatorët me FNT. Megjithatë AKEP ka vendosur për përdorimin e tarifave benchmark për terminimin e thirrjeve në rrjetin Albtelecom, përdorimi i informacionit nga llogaritë e ndara dhe llogaritja e kostove nga Albtelecom për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit, shërben për AKEP si informacion mbështetës në rregullimin e tarifave të këtyre shërbimeve si dhe parandalimin e sjelljeve antikonkurruese në tregjet e tjera ku Albtelecom ofron shërbime me status FNT ose pa status FNT. AKEP në analizën e tregut ka shqyrtuar konkurrencën në tregun e telefonisë fikse, dhe ka arritur në konkluzionin për de-rregullim të tregut me pakicë dhe të tregut me shumicë të origjinimit të thirrjeve në rrjetet fikse, duke marrë në konsideratë presionin konkurrues nga rrjetet celulare, deri në përfshirjen në një treg përkatës të tyre jo i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante. Duke marrë në konsideratë nivelin e të ardhurave të Albtelecom për vitin 2014 nga shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare dhe kostot shoqëruese të ndarjes së llogarive dhe llogaritjes së kostove të këtyre shërbimeve, së bashku me proceset shoqëruese, ato mund të rezultojnë jo-proporcionale (kosto të larta të implementimit të detyrimit në raport me të ardhurat apo peshën e tyre në tregun e komunikimeve elektronike),

por në një këndvështrim më të gjerë ato i shërbejnë rregullimit të ardhëshëm të këtyre shërbimeve si dhe shërbimeve të tjera të rrjetit fikse ku Altelecom ka status me FNT, si dhe janë një input i rëndësishëm në strategjitë rregullatore dhe politikave sektoriale për zhvillimet e rrjeteve të komunikimeve elektronike në Shqipëri. Sipas rregullores “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri”, miratuar me Vendim të KD të AKEP Nr. 2406, datë 26.12.2013, detyrimi për vitin 2014 është për kosto bazuar në kosto historike (HCA) dhe kosto plotësisht të shpërndara (FAC). AKEP gjykon se në kushtet aktuale të tregut është e arsyeshme të marrë në konsideratë implementimin e standardit të kostove korrente (CCA) dhe metodën e alokimit LRIC për vitin 2015 e në vijim, në një periudhë të mevonshme në këshillim dhe me palë të tjera të interesuara, përfshirë dhe Autoritetin e Konkurrencës, që ka vendosur detyrimin e ndarjes së llogarive të Altelecom sh.a. midis shërbimeve celulare dhe atyre fikse në vendimin e miratimit të bashkimit të kompanive Altelecom sh.a dhe Eagle Mobile sh.a.

4. Për sa më sipër AKEP gjykon të kryejë disa ndryshime në Vendimet nr.2617 dhe 2619, datë 8.10.2015, si dhe në Vendimet nr.2618¹ dhe 2620², datë 8.10.2015, për shkak se tarifat e terminimit në rrjetet fikse të operatorëve alternative dhe në rrjetin Telekom Albania (për thirrjet drejt numrave fikse) preken nga ndryshimet në këtë vendim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S:

1. Të pranojë pjesërisht ankimin administrativ të Altelecom sh.a kundër Vendimeve të Këshillit Drejtues Nr. 2617 dhe 2619 të datës 08.10.2015, të depozituar me shkresën Nr.8685, datë 09.11.2015.
2. Në Vendimin Nr.2619, datë 8.10.2015, për “Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjet fikse”, Tabela 1, në pikën 3.5/iii ndryshohet si më poshtë:

Tabela 1: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit dhe tranzitimit në rrjetin Altelecom 2014-deri në një vendim tjetër të AKEP

¹ VKD nr.2618, datë 8.10.2015 për “Përcaktimin e sipërmarrësve (lista në Aneks 1 e Anlizës së tregut) me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”

² VKD nr.2620, datë 8.10.2015 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Telekom Albania sh.a sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik Telekom Albania drejt numrave gjeografikë fikse² dhe vendosjen e masave rregulluese”

	Aktuale- 31.12.2015	Faza I	Faza II	Faza III
		1.01.2016- 31.12.2016	1.01.2017-31.12.2017	1.01.2018- deri ne nje Vendim tjetër te AKEP
Terminim (lek/minute)				
Lokal/njefish	1.19	1.48	1.29	0.70
Dyfish	1.85			
Tranzitim(lek/minute)	1.32	0.93	0.81	0.44
Tarifë fikse për thirrje ³(lek/thirrje)				
Tarife per thirrje	0.38	0.0	0.0	0.0

Tarifat jane shprehur pa TVSH

3. Në Vendimin Nr.2618, datë 8.10.2015, për “Përcaktimin e sipërmarrësve⁴ me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”, Tabela 1 në pikën 2.4/ii, ndryshohet si më poshtë:

Tabela 1: Vlerat maksimale te tarifave të terminimit në rrjetet e sipërmarrëve me FNT⁵

	Aktuale- 31.12.2015	Faza I	Faza II	Faza III
		1.01.2016- 31.12.2016	1.01.2017- 31.12.2017	1.01.2018- deri ne nje Vendim tjetër te AKEP
Tarifa per minute				
Lokal	1.34	1.48	1.29	0.70
Mesatare-Njefish/dyfish	1.77			
Tarife fikse për thirrje (lek/thirrje)	0.38	0.0	0.0	0.0

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

³ Aplikohet për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve.

⁴ Sipërmarrësit e shpallur me FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre janë dhënë në Listë në Aneks 1 të këtij Vendimi.

⁵ Sipërmarrësit e listës në Aneks 1 të këtij vendimi

4. Në Vendimin nr.2620, datë 8.10.2015, për “Përcaktimin e sipërmarrësit Telekom Albania sh.a sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik Telekom Albania drejt numrave gjeografikë fikse⁶ dhe vendosjen e masave rregulluese”, Tabela 1, në pikën 2.4/ii, ndryshohet si më poshtë:

Tabela 1: Vlerat maksimale te tarifave të terminimit në rrjetin Telekom Albania për thirrjet drejt numrave gjeografikë të Telekom Albania

	Aktuale- 31.12.2015	Faza I	Faza II	Faza III
		1.01.2016- 31.12.2016	1.01.2017- 31.12.2017	1.01.2018- deri ne nje Vendim tjetër te AKEP
Terminimi lek/minute	1.19	1.48	1.29	0.70
Tarife fikse per thirrje	0.38	0.0	0.0	0.0

Shenim: Tarifat jane pa TVSH.

5. Në dokumentin e Analizës së tregut të miratuar me Vendim nr.2617, datë 8.01.2015, Tabelat V.2.2 dhe V.3, si dhe paragrafet dhe tabelat e tjera të lidhura me to, ndryshohen sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
6. Të njoftohet Altelecom sh.a. dhe operatorët e tjerë për zbatimin e këtij Vendimi;
7. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R
Piro XHIXHO

ANËTARË:

Z.Alban KARAPICI

Znj.Anila DENAJ

Znj.Klarina ALLUSHI

Znj.Ketrin TOPCIU

⁶ Sherbimi telefonik GSM Fiks i tregtuar si Telekom Albania Fiks.